



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 33 prot.

Tiranë, më 17.01.2023

Drejtuar: Kryesisë së Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës

Letër ngushëllimi

Akademia e Shkencave e Shqipërisë mësoi sot lajmin e hidhur për ndarjen nga jeta të akademikes Edi Shukriu, anëtare e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, profesoreshë prej shumë vitesh e Universitetit të Prishtinës si dhe veprimtare e shquar politike e institucionale.

Ndarja nga jeta e akademikes Edi Shukriu është një humbje e thellë për familjen, ASHAK-un, Universitetin e Prishtinës dhe për gjithë shkencën shqiptare, si një emër i çmuar në fushën e arkeologjisë, fushë në të cilën ajo ka lënë gjurmë të pashlyeshme.

Duke qenë një ndër arkeologët e para shqiptare, ajo vuri themelet e dijeve arkeologjike në Kosovë, të cilave ua kushtoi tërë jetën, duke drejtuar institucione e projekte kërkimore shkencore.

Akad. Shukriu është e njohur edhe në fushën e letërsisë, ku ka lënë trashëgimi disa vepra poetike.

Në këto çaste të vështira, bashkohemi në këtë dhimbje me familjarët dhe të afërmit, kolegët dhe bashkëpunëtorët e saj.

I përjetshëm qoftë kujtimi i saj!

Në emër të Kryesisë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë,

Akad. Shaban Sinani

Sekretar shkencor

